



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1857/ 10 prot.

Datë 06.08.2024

**V E N D I M**

**Nr.1004/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.08.2024 , mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.955/2024, datë 24.07.2024 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF-12189-07-04-2024, me objekt: “Blerje kancelari dhe bojëra printeri”, me fond limit 1,620,870.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me Nipt (J62426002Q), me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km 8, Tiranë.  
Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, me Nipt (L82428011G), me adresë: Njesia Administrative nr. 10, Rruga "Fortuzi , Nr. 66/.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A, me adresë: Rruga Skenderbeu, Lagjia Qafë Gjashte, Sarandë .
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 24.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.955/2024, ku vendosi: [...]*1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, “BluePrint Technologies”, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-12189-07-04-2024, me objekt: “Blerje kancelari dhe bojëra printeri”, me fond limit 1,620,870.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A.*

*2. Të pranojë ankesat e operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, “Blue Print Technologies” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*

*3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*

*4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*

*5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, “Blue Print Technologies” SHPK.*

*6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.*

*7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 620/3 prot., datë 02.08.2024 protokolluar me tonën nr. 1857/7 prot., datë 05.08.2024 autoriteti kontraktor, njofton se [...] *“Referuar vendimit Tuaj, me nr. 955 date 24.07.2024, lidhur me procedurën e prokurimit me nr. REF 12189-07-04-2024, me objekt: “Blerje kancelari dhe bojëra printeri”, me fond limit 1,620,870.30(njemilion gjashtëqind e njetzetmije e teteqind e shtatedhjetë pike tridhjetë) leke pa TVSH, Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar, ju bejme me dije se : Në pikën III.2.4. të vendimit keni percaktuar : Ne këte kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për ndarjen e procedurës në lote, në respekt të parimit të barazisë, të nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; si dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. Ne këto kushte, AK e sheh të nevojshme të anullojë procedurën e prokurimit, për ta rihedhur persëri, duke gene se ndarja në lote percaktohet që në fazën e parë të hedhjes së një procedure në SPE. AK në hartimin e dokumentave standarte në procedurën me lote, do të ketë në konsideratë të gjitha sugjerimet Tuaja të percaktuara në vendimin e mësipërm. Sa sipër, kërkojme nga ana Juaj miratimin dhe heqjen e pezullimit të procedurës.[...]”.*

### II

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

## Arsyeton

II.1 . Me shkresën nr. 620/3 prot., datë 02.08.2024 protokolluar me tonën nr. 1857/7 prot., datë 05.08.2024 autoriteti kontraktor, njofton se [...] “Referuar vendimit Tuaj, me nr. 955 date 24.07.2024, lidhur me procedurën e prokurimit me nr. REF 12189-07-04-2024, me objekt: “Blerje kancelari dhe bojera printeri”, me fond limit 1,620,870.30(njemilion gjashtëqind e njetzetmije e teteqind e shtatedhjetë pike tridhjetë) leke pa TVSH, Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar, ju bejme me dije se : Në pikën III.2.4. të vendimit keni percaktuar : Ne këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për ndarjen e procedurës në lote, në respekt të parimit të barazisë, të nxitjes së pjesëmarrjes së operatoreve ekonomike në procedurat e prokurimit publik; si dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatoreve ekonomike. Ne këto kushte, AK e sheh të nevojshme të anulohet procedura e prokurimit, për ta rihedhur persëri, duke gene se ndarja në lote percaktohet që në fazën e parë të hedhjes së një procedure në SPE. AK në hartimin e dokumentave standarte në procedurën me lote, do të ketë në konsideratë të gjitha sugjerimet Tuaja të percaktuara në vendimin e mësipërm. Sa sipër, kërkojmë nga ana Juaj miratimin dhe heqjen e pezullimit të procedurës.[...]”.

II.1.2 Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor kërkon lejen mbi heqjen e pezullimit për vijimin e hapave të anulimit të procedurës për shkak se në vendimin e KPP Nr. 955/2024 datë 24.07.2024 KPP gjykoj se procedura duhet ndarë në lote.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-12189-07-04-2024, me objekt: “Blerje kancelari dhe bojera printeri”, me fond limit 1,620,870.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Sarandë SH.A.
  2. Me rihedhjen e procedurës Autoriteti Kontraktor të sjellë pranë KPP Dokumentet Standarte të tenderit në përputhje me konstatimet e vendimit të KPP Nr. 955/2024 datë 24.07.2024.
  3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Anila Malaj

Anëtar  
Kreshnik Ternova

Nënkryetar  
Fiorent Zguro

